



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:272042

Datë: 29.03.2023

Numri i dokumentit: 04135826

PKR.nr.218/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët profesionist Violeta Husaj Rugova – Kryetare, Sami Sharaxhiu dhe Musë Povataj – anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.B. nga P., rr. “Zh. S.”, nr..., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, dhe për veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të përgjithshme PP.II.nr.2450/2019 të datës 29.11.2019, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me datë 17.11.2022, 27.12.2022, 14.02.2023 dhe 28.02.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli të akuzuarit A. B. si dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit avokat Dukagjin Kërveshi me datë 01.03.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.03.2023 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. B.**, i lindur me datë, në P., ku edhe jeton, rr. “Zh. S.”, nr..., i biri i A. dhe i nënës A. e gjinisë T., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit sipas një lënde tjetër.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Më datë 16.09.2019 rreth orës 18:55 në P. në rrugën “Zh. S.” nr. .. për herë të parë pa autorizim posedon narkotik në atë mënyrë që i akuzuari ditën kritike merr një substancë të vogël narkotike të llojit marihuan në peshë 0.9 gr, të cilën pasi arrestohet nga policia e Kosovës të njëjtëve ua dorëzon narkotikun e lartcekur.

-Me këtë ka kryer veprë penale posedimi i pa autorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

II. Më datë 16.09.2019, rreth orës 17:00/h në P. Rr. “Zh. S.” nr..., brenda marrëdhënies familjare përdorë armën e llojit pistoletë Z. mm, me numër serik në mënyrë frikësuese dhe atë në dëm të dëmtuarit Rr. B. në atë mënyrë që i akuzuari ditën kritike pas një fjalosje me gjyshin e tij të dëmtuarin Rr. nxjerr armën e lartcekur dhe i drejtohet me fjalët se “do të fus ty “ e më pas me të shtije njëherë në drejtim të tokës.

-Me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, neni 269 par. 2 të KP të Kosovës, si dhe nenin 367 par. 2 të KPRK-së, e lidhur me nenin 364 të KPRK-së të akuzuarin e:

G J Y K O N

1. Për veprën e parë penale si në dispozitivin e parë të cekur si më lart dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj.

2. Për veprën e dytë penale të cekur si më lart, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro).

3. Konform nenit 76 shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e një muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro)

Dënimi me burg do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë do të ekzekutohet më së largu në afat prej 3 muaj nga disa e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftë se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti dënim do të zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

4. Të akuzuarit i konfiskohen:

-Narkotiku i llojit marihuan në peshë prej 0.9 gr.

-Arma pistoleta Z. mm, me numër serik të cilat gjenden në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor-DA-.... dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

5. I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro) në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të përgjithshme, pas zhvillimit të hetimeve ka ngrit aktakuzën PP.II.nr.2450/2019 të datës 29.11.2019, ndaj të akuzuarit A. B. nga P., rr. “Zh. S.”, nr..., për shkak të veprave penale posedimi i pa autorizuar i narkotikeve substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 2 të KPRK-së, mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 24.03.2021, në të cilin e ka njoftuar të akuzuarin lidhur me të drejtat e tij konform nenit 323 të KPPK-së. Para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit përmirëson aktakuzën sa i përket dispozitivit të parë për veprë penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duhet të jetë par.2 në vend të paragrafit 1 të KPRK-së, po ashtu hiqet nga kualifikimi i veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, heqet neni lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par.2 të KPRK-së, pasi që kjo është veprë e veçantë penale dhe është bërë gabim teknik gjatë përshkrimit të veprës, Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit. Në seancën e shqyrtimit fillestar dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar akuzën e ndryshuar sa i përket kualifikimit juridik, të akuzuarit iu ka dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me pranimin apo mos pranimin e fajësisë dhe njëkohësisht është njoftuar për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë. Me këtë rast i akuzuari ka deklaruar se i kupton pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e gjykatës, ndihet i pa fajshëm për veprat penale që i vihen në barrë dhe do të paraqet kundërshtim me shkrim me prova dhe me aktakuzë.

Me datë 22.04.2021 mbrojtësi i të akuzuarit A. B. në Gjykatë ka parashtrua kërkesë për kundërshtimin dhe përjashtimin e provave dhe për hedhje të aktakuzës.

Gjykata Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda me aktvendimin PKR.nr..../. të datëse ka hudh pjesërisht aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme PP/II.nr.2450/2019 të datës 29.11.2018 dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj të pandehurit A. B. sa i përket dispozitivit të III të aktakuzës për veprë penale mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së për shkak se prokurori në shqyrtimin e dytë ka heq dorë nga ndjekja penale sa i përket kësaj veprë penale. Ndërsa e ka refuzuar kundërshtimin-kërkesën e parashtrua nga mbrojtësi i të akuzuarit A.B., av.Dukagjin Kërveshi për hudhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme PP/II.nr.2450/2019 të datës 29.11.2019 për të akuzuarin A.B. sa i përket veprave penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së dhe për veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së si e pa bazuar.

Kundër aktvendimit të lartcekur sa i përketë pikës I dhe II ka parashtruar ankesë mbrojtësi i të akuzuarit. Gjykata e Apelit me aktvendim PN.nr..../. të dt..... e ka vërtetuar aktvendimin e lartcekur.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur ku i akuzuari sërish është njoftuar me të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës për pikën I dhe II të aktakuzës të përmirësuar nga ana e prokurorisë në shqyrtim fillestar dhe shqyrtim gjyqësorë është ftuar i akuzuarit që të deklarohet për fajësinë dhe është njoftuar paraprakisht me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë. I akuzuari ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me procedurën e provave.

Gjykata në procedurën e provave fillimisht ka dëgjuar fjalën hyrëse të palëve në procedurë dhe më pas janë lexuar këto prova materiale siç janë: raporti i policit Z. A. i datës 16.09.2019,raporti i policit F. B. i datës 16.09.2019, lista e armëve të konfiskuara e datës 16.09.2019, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e datës 16.09.2019, procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave e datës 16.09.2019 dhe janë shikuar dy fotografit e armës dhe një fotografi e narkotikut të sekuestruar, raporti i analizës së narkotikëve rast-.-.... i datës 14.02.2023, deklarata e të dëmtuarit Rr. B. e dhënë në prokurori me datë 26.11.2019 dhe deklarata e dhënë

në polici me datë 16.09.2019, si dhe janë lexuar deklaratat e të akuzuarit të dhëna në prokurori me dt.22.11.2019 dhe në polici me dt.16.09.2019.

I akuzuari në shqyrtim gjyqësor nuk është deklaruar ashtu që ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të dhënë mbrojtjen në heshtje.

Fjala përfundimtare

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se e bënë përmirësimin e dispozitivit si në vijim:

I akuzuari A. B. me datë 16.09.2019, rreth orës 18:55 në Pejë, në rr. Zh. S.” nr... për herë të parë pa autorizim posedon narkotik në atë mënyrë që i akuzuari ditën kritike merr një substancë të vogël narkotike të llojit marihuanë në peshë ... gr, të cilën pasi arrestohet nga Policia e Kosovës të njëjtëve ua dorëzon narkotikun e lartcekur.

- Me këtë ka kryer veprë penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari A.B. me datë 16.09.2019, rreth orës 17:00h në ., rr. “Zh. S.” nr..., brenda marrëdhënies familjare përdorë armën e llojit pistoleta Z. mm, me numër seriknë mënyrë frikësuese dhe atë në dëm të dëmtuarit Rr.B. në atë mënyrë që i akuzuari ditën kritike pas një fjalosje me gjyshin e ti të dëmtuarin Rr. nxjerr armën e lartcekur dhe i drejtohet me fjalët se “do të fus ty” e më pas me të shtije njëherë në drejtim të tokës.

-Me këtë ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së.

Më tej prokurori i shteti në fjalën përfundimtare me shkrim ka theksuar se: i akuzuari ka zgjedh të drejtën që të mbrohet në heshtje, të cilën gjë ia garantojnë të gjitha instrumentet si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, mirëpo kujtojmë se ai në mbrojtjen e tij të dhënë në stacion policor në Pejë me datë 16.09.2019 ndër të tjera kishte deklaruar “..kur ka bërtit gjyshi unë e kam nxjerr një armë zjarri të cilën e kisha në brezë... e kam drejtuar në drejtim të podrumit dhe kam gjuajtur njëherë... Marihuanën e kam pas në xhep jau kom dorëzu policisë kur mkan arrestu.. e ndi vetën fajtor, pendohem shumë për këtë”. I akuzuari edhe me datën 22.11.2019 në mbrojtjen e tij dhe në prokurori kishte deklaruar “Mua më vjen keq për rastin në fjalë e pranoj fajin për të gjitha veprimet e mija....”. Prokuroria deklaroi se mbrojtja edhe përkundër faktit se të gjitha provat janë shpall prova të pranueshme, prapë do të thirret se kinse kemi të bëjmë me prova të papranueshme. Kujtojmë se në rastin konkret assesi nuk kemi të bëjmë me urdhër kontroll për shkak se vet i akuzuari ka pranuar se narkotikun e ka dorëzuar vet Policisë së Kosovës, sikurse edhe armën për të cilat edhe i ka pranuar veprat penale. Po ashtu jemi të vetëdijshëm se mbrojtja do të thirret në atë se deklaratat e të dëmtuarit janë prova të pa pranueshme sepse nuk u është dhënë mundësia që ta sfidojnë atë deklaratë. Këso situatash provën nuk e bëjnë të pa pranueshme, ngase deklaratat e të dëmtuarit si ajo e dhënë në polici po ashtu edhe ajo e dhënë në Prokurori i përmbushim të gjitha garancionet procedurale dhe si të tilla trajtohen si prova të pranueshme plotësisht. Dallon situata kur i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor vetëm me një provë apo dëshmi të cilën mbrojtja nuk ka pas mundësi ta kundërshtoj dhe këtë gjë e ka rregulluar atë kohë neni 262 i KPRK-së. Mirëpo në rastin konkret sikurse u cek nuk bëhet fjalë vetëm për një provë por më shumë se tetë prova të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari i ka kryer veprat penale të lartcekura. Andaj nga të lartcekurat mbetet në tërësi pranë aktakuzës të përshkuara si në fillin të kësaj fjale përfundimtare

dhe i propozon Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor duke i shqiptuar dënimin e merituar. Me rastin e matjes së dënimit Gjykatës i propozon që si rrethana rënduese konform nenit 70 par.2 nën par. 2.7 të KPRK-së të merret për bazë moshë e viktimës i cili ishte i moshës .. vjeçare. Konform nën par. 2.13 të nenit të lartcekur si rrethanë rënduese të merret për bazë e kaluara e të akuzuarit i cili është dënuar në bazë të aktgjykimit PKR.nr.167/21 të datës 17.11.2021 në të cilin i akuzuari është shpall fajtor për vepër penale vrasje nga neni 172 i KPRK-së me dënim me burgim prej 8 vite, e që me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.nr.513/21 të datës 21.02.2022 dënimi i lartcekur i është zbritur në 6 vjet. Në kuptim të nenit 70 par.2 nën par. 2.14 të KPRK-së si rrethanë tjetër rënduese të merret për bazë fakti se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare gjegjësisht në dëm të gjyshit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B. av. *Dukagjin Kërveshi* në fjalën e tij përfundimtare të parashtruar me shkrim ka theksuar se: në lidhje me pretendimet e prokurorisë për kryerjen e veprës penale “Posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.2 të KPRK-së, konsiderojnë se kjo vepër penale bazohet ekskluzivisht në prova të pa pranueshme të marra nga bastisja policore e kundërligjshme e cila është realizuar në shtëpinë e të akuzuarit pa urdhër paraprak të gjykatës. Ndërsa në lidhje me pretendimin e prokurorisë për kryerjen e veprës penale të “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 i KPRK-së konsiderojnë se gjatë këtij shqyrtimi veprimi i përdorimit të armës nga ana e të akuzuarit nuk është argumentuar me asnjë provë të vetme objektive dhe direkte, çoftë të predhës së shkrepur, vendit të goditjes së predhës, gëzhgojës, ekzaminimi i pistoletës, nëse është shtënë nga e njëjta armë e konfiskuar gjatë bastisjes së kundërligjshme, edhe ekzaminimi i të akuzuarit me teste përkatëse për të zbuluar gjurmë të grimcave të barotit në pjesë të trupit apo rrobat e tij. Dy deklaratat e palës së pretenduar si e dëmtuar, si prova të cilat trupi gjykues gjatë shqyrtimit ligjor vendosi ti lexoj për të vërtetuar faktin e përdorimit të armës, nuk konsiderohen si prova direkte në bazë të cilave ekskluzivisht i mbrojturi do të mund të shpallej fajtor. Këto dy deklaratat e tij të dhëna gjatë hetuesisë nuk arrijnë standardin e provës direkte për një vendim gjyqësor fajësues për faktin se mbrojta e të akuzuarit nuk ka qenë prezent gjatë dhënies së tyre për të sfiduar kredibilitetin, parashtruar pyetje edhe vërejte, derisa në shqyrtimin kryesor gjyqësor ishte objektivisht e pamundur për ta ballafaquar me to, dhe me marrje në pyetje të tërthortë nga ana e mbrojtës për shkak të vdekjes së tij. Po ashtu në shkresat e lëndës nuk ekziston dëshmia e ekzaminimit mjekësor në lidhje me aftësinë e tij mendore, meqenëse ishte në moshë të shtyrë, edhe i njëjti sipas fletë lëshimit mjekësor të dorëzuar nga mbrojta është pranuar në QKUK për shkak të çrregullimit të vetëdijes. Mbrojta vazhdon ti sfidoj si ligjshmërinë ashtu edhe legjitimitetin e bastisje dhe provave të siguruar nga kjo bastisje në pajtim me doktrinën ndërkombëtare e “frutave të pemës së helmuar”, këto prova si të kundërligjshme nuk e plotësojnë standardin për vlerësim të lirë nga ana e Gjykatës, si edhe deklaratimet në hetuesi të palës së pretenduar si e dëmtuar pa u ballafaquar në shqyrtim kryesor nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor meritor. Andaj kërkon nga Trupi gjykues me kujdes ta bënë analizën profesionale dhe vlerësimin e ndërgjegjshëm të validitetit dhe fuqisë provuese të gjitha provave, nga i cili vlerësim do të rezultojë me marrje të vendimit të drejt, dhe ky vendim nuk mund të jetë tjetër pos një vendim lirues nga aktakuza, në kuptim të nenit 363 piks 1.1.3 të KPPRK-së në fuqi, sepse nuk është provuar se i mbrojturi i im ka kryer dy veprat penale me të cilat është akuzuar

I akuzuari A.B. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, e mbështet fjalën e avokatit të tij.

Gjykata pas administrimit të provave dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i ka vlerësuar provat e administruara një nga një dhe në lidhmëni reciproke me njëra tjetrën dhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur elementet e veprave penale që i vihen në mbarë sipas aktakuzës dhe atë: veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave

psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së.

Gjendja e vërtetuar faktike

Me provat të administruara është vërtetuar se:

-I akuzuari me datë 16.09.2019, rreth orës 17:00/h në P. Rr. “Zh. S.” nr..., përdorë armën-pistoletën e llojit Z. mm, me numër serik

-Armën e kishte përdorë në mënyrë frikësuese dhe atë në dëm të dëmtuarit Rr.B.

-I akuzuari ditën kritike pas një fjalosje me gjyshin e tij të dëmtuarin Rr. nxjerr armën e lart cekur, i drejtohet me fjalët se “do të fus ty” e më pas me të shtije njëherë në drejtim të tokës.

-Pasi shtënë me armë i akuzuari largohet nga shtëpia, ndërkaq i dëmtuari Rr.B. i kishte lajmëruar organet policore të cilët kishin dal në vendin e ngjarjes por i akuzuari nuk ishte në shtëpi.

- Kur ishte kthyer i akuzuari, i dëmtuari sërish i kishte lajmëruar organet policore të cilët i janë përgjigjur dhe kanë shkuar te shtëpia e të dëmtuarit të njëjtën ditë rreth orës 18:55 , ku dhe kishin has të akuzuarin në korridor të shtëpisë, i cili armën e kishte në brez dhe i merret nga zyrtari policorë E. Ll..

-Të akuzuari A.B. në të njëjtën kohë i bëhet kontrolli trupor ku në xhep kishte substancë narkotike të cilën i njëjti e nxjerr nga xhepi dhe ia dorëzon policisë.

-Pas ekzaminimit substanca narkotike ka rezultuar të jetë e llojit M. me peshë ... gr.

Fakte të pa kontestuar

Gjatë shqyrtimit kryesor nuk është kontestuar posedimi i e pa autorizuar e narkotikëve dhe posedimi i armës, dhe nuk është kontestuar konfiskimi i tyre nga organet policore.

Fakte të kontestuar

Gjykate shqyrtimit gjyqësor u kontestua ligjshmëria e procesverbalit për bastisjen si dhe ligjshmëria e konfiskimit të substancës narkotike dhe armës në mungesë të urdhrat gjyqësor për bastisje. Po ashtu u kontestua edhe përdorimi i armës nga ana e të akuzuarit.

Provat që vërtetojnë gjendjen faktike

-Nga Raporti i polices F. B. i datës 16.09.2019 vërtetohet se rreth orës 17:20 operativa i kishte njoftuar patrullën e tyre se i dëmtuari Rr.B. e kishte lajmëruar Qendrën Operative, se në Rrugën Zh. S. nr... kishte problem me A. B.. Patrolla e tyre në thirrje ../. ishin njoftuar nga Operativa dhe këta ju kanë përgjigjur rastit dhe kanë takuar Rr. B. i cili i ka njoftuar se me dt.16.09.2019 rreth orës 17:00 ishte në shtëpi aty kishte ardhur djali i djalit të tij A. B. me një armë në dorë në madhësitë të vogël ngjyrë kafe. Rr.i i kishte thënë “që ta largoj armën se nuk ka gjë hajrë nga ajo “ ku ai ju kishte përgjigjur “ju ka mërzitur jeta se e mban mend se çka i kishte bërë babai i tij”. Pastaj prape Rr.i i kishte thënë që ta largon armën. A. i ka thënë se “do ta fus ty”. Rr.i i kishte thënë “qit qit” në ato momente kishte gjuajtur me armë zjarri një herë në podrum dhe A.

e kishte marrë gëzhojën nga aty e ka gjuajtur në kanatën e bërllokut. A. me vëllain e tij ishin larguar nga shtëpiak dhe kishin shkuar në drejtim të panjohur.

-Nga raporti i policit Z.A. i datës 16.09.2019, vërtetohet se i dëmtuari Rr. B. e kishte lajmëruar Qendrën Operative në Pejë rreth orës 18:50 se në shtëpi kishte ardhur personi A.B. dhe së bashku me njësitin përkatës kishin shkuar në shtëpi te i dyshimti rrethores 18:55 dhe në brendi të shtëpisë në korridore është hasur i dyshimti dhe Kapiteni E. Ll. nga brezi i të dyshimitit ka marrë armën pistoletën Z. M. .. kal..... mm me numër serik me një karikator dhe tre fishek të kal.... mm, dhe në trupin e të dyshimitit gjatë kontrollit i është gjetur një substancë e vogël narkotike që dyshohet të jetë marihuarn. Pastaj në vend të ngjarjes kishte shkuar edhe krim teknika e cila ka bërë konfiskimin e armës dhe substancës narkotike. Pastaj me pëlqimin e pronarit të shtëpisë Rr.B. është bastisur dhoma dhe lokacioni ku jetonte i dyshimti po nuk kishte hasur asgjë e dyshimtë.

-Lista e armëve të konfiskuara e datës 16.09.2019, vërtetohet se të akuzuarit i është konfiskuar një pistoletë e kalibritmm me numër serik

-Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve e datës 16.09.2019, vërtetohet se të akuzuarit i është konfiskuar një qese me substancë narkotike.

-Nga dy fotografit e armës dhe një fotografi e narkotikut të sekuestruar me numër-.-....., vërtetohet se të njëjtat ishin fotografuar dhe arma ka numrin serik, ndërkaq substanca është një qese e vogël e përshkruar si në vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

-Nga Raporti i analizës së narkotikëve me numër të rastit-.-..... i datës 14.02.2023, vërtetohet se nga dëshmia e evidentuar ..., që ishte konfiskuar nga i akuzuari, sipas analizës së bërë me pajisjen NarTest NTX2000, ka rezultuar si pozitiv dhe është cilësuar si substancë narkotike e llojit Marihuanë dhe ka peshën ... gram.

Gjykata konform nenit 335 par. 1 nën par.1.1 të KPPRK-së, ka lexuar deklaratën e të dëmtuarit Rr.B. e dhënë në prokurori me datë 26.11.2019 dhe deklaratën e dhënë në polici me datë 16.09.2019, pasi që i njëjti kishte vdekur. Vdekjen e të dëmtuarit e vërteton raporti i QKUK-së në Prishtinë i dt.01.08.2021, ku është konstatuar vdekja e Rr.B. me dt. 01.08.2021. Po ashtu edhe nga njoftimi i Zyrës Komunale të gjendjes Civile në P. të dt.07.02.2023, rezulton se është bërë verifikimi dhe nga sistemi kanë konstatuar se Rr. A. B. me nr. Personale ka vdekur me dt.01.08.2021 dhe njoftimit i kanë bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes.

-Nga deklarata e të dëmtuarit Rr.B. të dhënë në polici me datë 16.09.2019 vërtetohet në tërësi ajo që është konstatuar edhe në raportin e polices F. B., se ishte në shtëpi dhe ka ardhur A.B. djali i djalit, e kishte armën në dorë dhe i kishte thënë “largo armën se nuk ka gjo hajr”, ai ju ka përgjigj se “mu ka mërzi jeta” se e mbaj në mend se çka më ka bo babai im, e mandej mem friksu mu tha po ta fus ty dhe i thash qit, ai e kthej armën në posht dhe gjuajti një herë, e futi armën në shok dhe e thirri vllaun e vet .. vjeçar E. dhe i tha hajde shkojmë, kur ai ka dalur nga shtëpia i dëmtuari ka menduar se po shkon te babi i tij. Ai gëzhjojën e ka marr dhe e ka gjuajtur në kantën e bërllokut. Pranë deklaratës së dhënë në polici kishte mbetur edhe më rastin e dëgjimit të tij në prokurori me dt.26.11.2019.

-Nga procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave e datës 16.09.2019 rezulton se policia kishte kontrolluar dhomën ku qëndronte i akuzuari, e që në raportin e policit Z.A. bastisja ishte bërë me pëlqimin e pronarit të Shtëpisë Rr.B., megjithatë nuk kishte pëlqimi me shkrim. Andaj

gjykata këtë procesverbal sa i përket kontrollit të dhomës së shtëpisë ku jetonte i akuzuari nuk e mori për bazë dhe ashtu nuk ka rezultuar me asgjë. E sa i përket kontrollit të personi dhe marrjes së armës dhe narkotikut e më pas konfiskimit, gjykata vlerësoj se kontrolli është bërë konform dispozitave ligjore pasi që arma fillimisht i është marr nga brezi për mënjanimin e rrezikut gjë që është obligim policorë konform nenit 110 par.1 nën par. 1.1, 1.2,1.3,1.4 të KPPRK-së që ishte në fuqi, pasi që vetë pronari i shtëpisë në këtë rast i dëmtuari kishte thirrë për ndihmë dhe i akuzuari ishte i armatosur dhe paraqiste rrezik. E sa i përket narkotikut, vetë i akuzuar në polici ka deklaruar se ua ka dorëzuar vetë policisë substancën narkotike pasi që e kishte në xhep.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

I akuzuari A. B. e ka shfrytëzua të drejtën që të mbrohet në heshtje, mirëpo gjykata i vlerësoj deklaratat e të akuzuarit të dhëna gjatë procedurës hetimore me datë 16.09.2019 në polici dhe 22.11.2019 në prokurori, deklarata këto të dhëna në prezencë të mbrojtëses së tij Elvane Gjakova të cilat janë administruar si prova në kuptim të nenit 119 par. 5 lidhur me nenin 256 të KPPRK-së. Në këto deklarata nuk e mohon se ka shtënë me armë natën kritike por jo në drejtim të gjyshit të tij po te poshtë në drejtim të podrumit, si dhe faktin kishte konsumuar narkotik dhe më parë për qetësim, se posedonte narkotikun të cilin e kishte blerë nga disa persona të komunitetit egjiptian në parkun K. bashkë me armen, nuk e mohon se ka pas fjalë me gjyshin e tij dhe faktin shkrepjes me armë të ketë dalë nga shtëpia. Pra deklaratat e tij të dhëna në procedurë paraprake ishin në përputhje me provat e administruara dhe të vlerësuara si më lartë. Prandaj lidhur me këto rrethana gjykata i mori për bazë me rastin e vendosjes së kësaj çështje por jo si provë e vetme fajësuese por në lidhmëni edhe me provat e tjera të cekura si më lartë të cilat ishin në përputhje me këto deklarata të akuzuarit.

I akuzuari me rastin e dhënies së këtyre deklaratave e ka mohuar se ka shtënë me qellim të friksimit, por shkrepja ishte bërë pasi gjyshi tentonte t'ia hiqte armen nga dora. Por deklarimin e tij lidhur me këtë rrethanë, gjykata nuk e mori për bazë dhe vlerësoj se me këtë i akuzuari pretendon të shmanget nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka kontestuar procesverbalin mbi bastisjen e banesës dhe personave e datës 16.09.2019 në të cilin procesverbal është bastisur shtëpia e Rr. B. dhe nuk ishte gjetur asgjë. Është konstatuar se gjatë kontrollit trupor në xhepin e A.B. është gjetur substanca e dyshuar narkotike e llojit marihuan. Pretendimi i mbrojtjes është se bastisja është bërë në mënyrë të kundërligjshme. E po ashtu në mënyrë të kundërligjshme është bërë edhe konfiskimi i sendeve nga i akuzuari.

Gjykata i vlerësoj këto pretendime të mbrojtjes dhe sa i përket procesverbalit mbi bastisjen e shtëpisë dhe e vlerësoj si të bazuar pjesërisht siç u cek më lartë, pasi që shtëpia ishte bastisur pa urdhër të gjykatës e dhënia e pëlqimit nga pronari i shtëpisë Rr.B. nuk ishte bërë me shkrim ashtu siç parasheh dispozita ligjore. Ndërkaq sa i përket kontrollit të personit dhe konfiskimit të substancës narkotike gjykata e vlerësoj si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimit se arma dhe narkotiku i janë konfiskuar në mënyrë të kundërligjshme gjykata e vlerësoj se konfiskimi në këtë rast nuk ka të bëjë me bastisje por me kontroll të personit, pasi që paraprakisht i dëmtuari kishte thirr për ndihmë për shkak se i akuzuarit kishte shtënë me armë, kur kanë shkuar organet policore i akuzuari nuk ka qenë aty. Pastaj sërish përafërsisht pas jo tërësisht një orë, kur kishte ardhur i akuzuari në shtëpi i dëmtuari Rr. sërish i kishte thirr operativen- organet policore dhe i kishte njoftuar i akuzuari ishte kthyer në shtëpi

dhe policia duke ditur se i dëmtuari kishte thirr për ndihmë rreth problemit që kishte me të akuzuarin ku i njëjti kishte shtënë me armë kishin hy dhe në korridor kishin has të akuzuarin ku menjëherë nga Brezi zyrtari policorë E. Ll. i kishte marr armën, pastaj gjatë kontrollit trupor, është has edhe në substancë narkotike të cilën i akuzuari e kishte në xhepi dhe e nxjerr dhe ua dorëzon policisë të cilën ia konfiskojnë policia. Gjë që rezulton nga raportet policore të cekura si më lartë dhe nga vërtetimi dhe dëftesa për konfiskimin e sendeve të cekura dhe të vlerësuara si më lartë si dhe deklaratat e të akuzuarit të dhëna në procedurë paraprake të cekura si më lartë. Andaj gjykata duke pas parasysh të gjitha këto ka vlerësuar se në këtë drejtim pretendimet e mbrojtjes janë të pa bazuara.

Kontrolli i personit ishte bërë ashtu siç parashohin dispozitat ligjore që ishin në fuqi për kontrollin e përkohshëm për siguri kur dyshohet se personi është i armatosur. Pra ky kontroll dhe konfiskimi është bërë konform nenit 70, 75, 105 par. 1 dhe neni 110 par.1 nën par. 1.1, 1.2,1.3, 1.4 të KPPRK-së (kod ky në fuqi në atë kohë), pasi që zyrtaret policor ishin ftuar nga vetë pronari i shtëpisë i cili kishte thirrë për ndihmë dhe i akuzuari ishte me armë, për çka policia kishte hy në korridor të shtëpisë dhe kishte gjet të akuzuarin të cilit fillimisht ia kanë armën që kishte në brez, dhe më pas me rastin e kontrollit i akuzuari vet ua kishte dhënë substancën narkotike të cilën e kishte në xhep, gjë që e pohon me rastin e dhënies së deklaratës në polici.

Pretendimin e mbrojtjes se nuk ka prova që arma është përdorur gjykata e vlerësoj si të pa bazuar, pasi që nga raporti i polices F. B. ku ishte konstatuar se i dëmtuari Rr.B. ka deklaruar se i akuzuari kishte shtënë me armë, pasi që i dëmtuari i kishte thënë lartë armën se nuk të duhet gjë dhe ai i ka thënë “ta fus ty”, pastaj nga deklaratat e të dëmtuarit të dhëna në procedurë paraprake si dhe nga vetë deklarimi i të akuzuarit të dhënë në polici pranë të cilit kishte mbetur edhe me rastin e dhënies së deklaratës në prokurori. Është fakt që gëzhoja nuk është gjetur por i dëmtuari ka deklaruar se i akuzuari e ka marr gëzhojën dhe e ka gjuajt në bërlllok.

Gjykata e vlerësoj edhe aktvendimet PKR.../.. i vërtetuar me aktvendim PN.nr.870/2021 për shpallje të provave të pa pranueshëm në raste tjetër si praktikë gjyqësore, të dorëzuara nga mbrojtësi në fjalën përfundimtare, por gjykata vlerëson aktvendimet kanë të bëjnë për rast tjetër dhe secili rast është rast në vete dhe vlerësohen rrethanat konkrete në të cilat është ndërmarr veprimi i caktuar. Andaj ishin jo relevante në rastin konkret.

Vlerësimi ligjorë

Gjendjen faktike të vërtetuar gjykata e vlerësoj në raport me provat e administruara e të vlerësuara si më lartë si dhe në raport me elementet e veprave penale që i vihen në barrë sipas aktakuzës. Andaj gjykata erdhi në përfundim se me provat e administruar u vërtetua se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e veprave penale: *posedimi i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, dhe për veprë penale *përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm* nga neni 367 par.2 të KPRK-së, pranë të cilave mbeti në fjalën përfundimtare.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i akuzuari ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryej në mënyrë të përshtuar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që ka qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera. Armën e kishte përdor në mënyrë frikësuese ku i kishte thanë gjyshit të tij se “ta fus ty” e pastaj kishte gjuajtur në drejtim të tokës. Ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Vendimi mbi dënim

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara për të vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së.

Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata gjen se i akuzuari në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re sapo kishte arritur moshën madhore, kishte 18 vjet e dy muaj.

Si rrethana renduese për të akuzuarin gjykata mori për bazë rrethanat në të cilat ishte përdorur arma, pra ishte përdorur te shtëpia e gjyshit të tij ku banonte edhe vet i akuzuari, pastaj pas kryerjes së këtyre veprave penale është gjykuar dhe është shpall fajtorë me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë Departamenti për krime të rënda PKR.nr.167/21 të datës 05.11.2021 për veprë penale vrasje nga neni 172 të KPRK-së (vepër kjo e kryer me dt.05.09.2020), i cili aktgjykim është ndryshuar vetëm sa i përket vendimit për dënim me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës PAKR.nr.513/2021 të datës 21.02.2022, ku i njëjti është në vuajtje të dënimit me burg në lartësi prej 6 viteve.

Marrë parasysh rrethanat për dënimin të cekura më lartë Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimet e shqiptuara të akuzuarit janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-Së.

Vendimi mbi konfiskim

Vendimi mbi konfiskimin i cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është marrë bazuar: lidhur me veprën e parë penale në dispozitivin e nenit 269 par. 3 të KPPRK-së, për veprën e dytë penale në dispozitivin e nenit 367 par.3 të KPRK-së pasi që i akuzuari armën e mbante pa leje përkatëse në mënyrë të kundërligjshme, dhe të njëjtën e kishte përdorë, edhe pse siç është cekur më lartë prokurori ka heq dorë nga vepra penale mbajtja në pronësi kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, pasi që në atë kohë ka qenë periudha e legalizimit të armëve dhe gjykata me aktvendim të cekur si më lartë PKR.nr.218/2020 të dt.07.05.2021 ka hudh pjesërisht aktakuzën sa i përket kësaj veprë penale, pasi

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësorë

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor bazuar në nenin 449 të KPPK-së.

Vendimi mbi kompensim të viktimave të krimit

Vendimin për taksën për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par. 3 nën par 3.2 të Ligji Nr. 05/L -036 Për Kompensimin e viktimave të krimit.

Lidhur me Kërkesën pasurore juridike

I dëmtuari Rr.B. ka marr pjesë vetëm në shqyrtim fillestarë, ku nuk është deklaruar për kërkesën pasurore juridike dhe siç u cek më lartë ka vdekur para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Në shqyrtim gjyqësor nuk është paraqitur ndonjë person familjar i tij për tu deklaruar për vdekjen e tij, përkatësisht për ta njoftuar gjykatën për vdekjen e tij, e as për tu deklaruar për propozimin për kërkesën pasurore juridike (ftesa për shqyrtim gjyqësor të dt.17.11.2022 është dërguar dhe është nënshkruar të rubrika marrësi por nuk është konstatuar se kush është nënshkruar). Vërtetimi se i njëjti ka vdekur është bërë me provat e cekura më lartë pasi që i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë deklaruar se i njëjti ka vdekur. Andaj gjykata nuk ka pas mundësi të vendos lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPRK-së (kodi nr.08/L-032) është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

2019:272042, 29.03.2023

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.